



NË MITROVICË TË VERIUT DHE LEPOSAVIQ NIS PETICIONI PËR SHKARKIMIN E KRYETARËVE SHQIPTARË **FAQE 4-5**



Në Mitrovicë të Veriut dhe Leposaviq të mërkurën ka nisur peticioni për shkarkimin e kryetarëve shqiptarë. Në vendet ku po grumbullohen nënshkrimet e qytetarëve ishin të pranishëm përfaqësuesit e

Listës Serbe, e cila bojkotoi zgjedhjet dhe përfaqësuesit e saj u larguan nga institucionet e Kosovës dhe nxitën largimin edhe të serbëve të tjerë. Në mënyrë që peticioni të jetë i suksesshëm, kërkohet që të

mblidhen të paktën 20 për qind e nënshkrimeve nga numri i përgjithshëm i votuesve të regjistruar. Qytetarët e komunave serbe në veri kanë afat për të mbledhur nënshkrime deri më 22 janar

KONJUFCA PARALAJMËRON ZGJEDHJE TË JASHTËZAKONSHME **F. 6**



WILLIAM WALKER:
UNË BESOJ
NË DREJTËSI,
POR KJO NUK
PO NDODH NË
GJYKATËN
SPECIALE **F. 3**



AKTUALE



MINISTRI I JASHTËM I MAQEDONISË:
MBËSHTETJA E LV-SË PËR OPOZITËN
NUK DO TË NDIKOJË NË PROCESIN
ZGJEDHOR **F. 3**

OSMANI DHE KONJUFCA BËJNË
HOMAZHE TE VARRET E JUSUF DHE
BARDHOSH GËRVALLËS NË DUBOVIK **F. 6**

NË FAKULTETIN JURIDIK
THEMELOHET QENDRA PËR STUDIMIN
E GJENOCIDIT, HOLOKAUSTIT
DHE DREJTËSISË TRANZICIONALE **F. 7**


EKONOMI



TRUSTI PËRMBYLL VITIN 2023 ME
RRITJE RRETH 90 MILIONË EURO **F. 8**

KURTI VIZITON PANAIRIN
NDËRKOMBËTAR 'SWISS BAU 2024',
SHEH NGA AFËR PRODHIMET
E KOMPANIVE NGA KOSOVA **F. 8**

SPORT



DUKA: TIFOZËT TANË
DO TA 'SKUQIN' GJERMANINË **F. 10**

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
030-500 878 | 045-500 878
044-500 878 | 049-500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Kina regjistron sërish rënie të numrit të popullsisë

BEIJING, 17 JANAR - Popullsia e Kinës është zvogëluar për të dytin vit me radhë, duke rritur shqetësimet në vendin me ekonominë e dytë më të madhe në botë. Të dhënat e publikuara të mërkurën kanë treguar që Kina ka pasur 1.409 miliard banorë deri në fund të vitit 2023 - 2.08 milionë më pak sesa më 2022. Shifrat e fundit janë dyfish më të mëdha sesa në vitin paraprak, të cilat patën shënuar rënien e parë në 60 vjetët e fundit. Ekspertët kanë thënë se një rënie e tillë ka qenë e pritshme për shkak të zgjerimit të klasës urbane dhe

zvogëlimit të numrit të lindjeve. Të mërkurën Pekini ka thënë se shkalla e lindshmërisë ka rënë në 6.39 për 1 000 banorë dhe trendi është në linjë me vendet e tjera të avancuara të Azisë Lindore, Japoninë dhe Korenë e Jugut. Një arsye tjetër për rënie të numrit të popullsisë ka qenë edhe politika që një familje të ketë vetëm një fëmijë - e cila ka datuar prej viteve 1980 - për ta kontrolluar mbipopullimin në atë kohë. Qeveria e ka pezulluar atë politikë më 2015, me qëllim të shmangies së trendit të rënies së

numrit të popullsisë dhe ka paraqitur masa të tjera për nxitje të natalitetit. Më 2021 autoritetet i kanë relaksuar edhe më shumë masat, duke ua mundësuar çifteve t'i kenë deri në tre fëmijë. Të dhënat e fundit kanë rritur shqetësimet për ekonominë kineze, pasi ky vend e ka fuqinë punëtore si motorin kryesor për qarkullim financiar. Ndonëse dikur ka qenë vendi më së shumti popullsi në botë, tani India është vendi që e mban primatin. Sipas të dhënave të Kombeve të Bashkuara më 2022, India ka 1.425 miliard banorë.



Blinkeni thotë se Izraeli duhet ta ndihmojë Autoritetin Palestinez



DAVOS, 17 JANAR - Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, i bëri thirrje Izraelit të ndihmojë, e jo të pengojë, Autoritetin Palestinez, duke theksuar se siguria afatgjatë e Izraelit është në rrezik. Duke folur në Forumin Ekonomik Botëror në Davos të Zvicrës, Blinkeni përsëriti thirrjen e tij për “një rrugë drejt një shteti palestinez”, përkundër që Uashingtoni mbështet fushatën izraelite në Gazë që Izraeli nisi në përgjigje të sulmit të 7 tetorit të kryer nga Hamasi - grupi palestinez i shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi

Evropian. “Në mungesë të kësaj, ju nuk do të keni sigurinë që ju duhet. Dhe, sigurisht që një Autoritet Palestinez, i fortë dhe i reformuar i cili mund të jetë më efektiv që të prodhojë rezultat për popullin e tij, duhet të bëhet pjesë e ekuacionit”, tha Blinken. Një Autoritet Palestinez efektiv mund të operojë vetëm “me mbështetjen, me ndihmën e Izraelit e jo me kundërshtimin e tij”, shtoi kryediplomati amerikan. ShBA-ja e ka mbështetur thirrjen e kryeministrit izraelit Benjamin Netanyahu për zhdukjen e Hamasit, që kontrollon Rripin e

Gazës, por ka bërë thirrje që Autoriteti Palestinez, që udhëhiqet nga Mahmoud Abbas në Bregun Perëndimor, gradualisht ta marrë kontrollin e Rripit të Gazës. Netanyahu që një kohë të gjatë është shprehur kundër një shteti palestinez. Luftimet në Gazë shpërthyen pasi Hamasi kreu sulm në jug të Izraelit, duke vrarë afër 1 200 persona dhe duke rrëmbyer afër 250 të tjerë. Sipas autoriteteve shëndetësore në Gazën e udhëhequr nga Hamasi, mbi 24 000 palestinezë janë vrarë gjatë ofensivës izraelite në Rripin e Gazës.

Izraeli kryen sulme vdekjeprurëse ajrore në Bregun Perëndimor

NABULS, 17 JANAR - Ushtria izraelite tha se ka vrarë një militant të lartë palestinez përmes një sulmi ajror në Bregun e pushtuar Perëndimor. Ahmed Abdullah Abu Shalal, i cili sipas ushtrisë izraelite ishte përgjegjës për infrastrukturën dhe kishte planifikuar disa sulme kundër izraelitëve në Jerusalem, ishte në mesin e katër të vrarëve gjatë sulmit të kryer mëngjesin e së mërkurës në kampin e refugjatëve Balata në qytetin Nablus. Gjysmëhëna e Kuqe palestineze

tha se forcat izraelite kanë parandaluar mjekët që të shkojnë në vendin e ngjarjes. Kjo organizatë tha përmes rrjeteve sociale se “të shtënat me armë zjarri iu drejtuan ekipeve tona”. Ushtria izraelite pretendoi se Abu Shalal dhe celula e tij planifikonin të kryenin një sulm dhe kishin marrë fonde dhe udhëzime nga “burimet iraniane”. Ushtria nuk ofroi dëshmi për këto pretendime. Dhuna ka shpërthyer në Bregun Perëndimor të pushtuar nga Izraeli,

që kur ka nisur lufta në Gazë në mes të Izraelit dhe Hamasit - grupit palestinez të shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian. Mbi 350 palestinezë janë vrarë në tre muajt e fundit, sipas Ministrisë së Shëndetësisë, shumica gjatë bastisjeve izraelite dhe protestave të dhunshme. Izraeli ka shtuar sulmet ajrore në Bregun Perëndimor, por vrasjet e shënjestruara janë kryesisht të rralla në këtë territor.



Reshjet e borës shkaktojnë anulimin e fluturimeve në Gjermani



BERLIN, 17 JANAR - Reshjet e dendura të borës dhe ato të shiut në mbarë Gjermaninë më 17 janar kanë shkaktuar anulimin e qindra fluturimeve dhe linjave të transportit me trena si dhe mbylljen e shkollave. Në aeroportin e Frankfurtit, që është aeroporti më i madh në Gjermani, mbi 500 fluturime janë anuluar. Ndërkaq, në Munih mbi 250 fluturime që pritej të aterronin dhe të

niseshin, po ashtu u anuluan. Aeroporti Saarbruecken në perëndim të Gjermanisë u mbyll përderisa aeroportet në Dyseldorf dhe Koln, po ashtu janë prekur nga vonesat dhe anulimet e fluturimeve. Operatori kombëtar i trenave, Deutsche Bahn, ka anuluar disa udhëtime në distancë të gjatë dhe ka njoftuar se maksimumi i shpejtësisë së trenave të tij të shpejtë do të kufizohet deri në 200 kilometra në orë për shkak

të motit ekstrem. Reshjet e shiut në mbarë Gjermaninë perëndimore dhe jugore po ashtu kanë shkakuar ngrirjen e rrugëve, gjë që ka rezultuar me shumë aksidente rugore mëngjesin e së mërkurës. Si masë parandaluese, shumë shkolla dhe çerdhe në vend janë mbyllur, ndërkaq disa kompani u kanë ofruar punonjësve të tyre mundësinë që të punojnë nga shtëpia.

Ministri i Jashtëm i Maqedonisë: Mbështetja e LV-së për opozitën nuk do të ndikojë në procesin zgjedhor

SHKUP, 17 JANAR - Ministri i Punëve të Jashtme i Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmani, tha se përfshirja e politikës zyrtare të Kosovës në skenën politike të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut “nuk do të ndikojë në procesin zgjedhor”, por “mund të reflektohet në fragmentimin e politikës shqiptare, tendencë e nxitur nga faktorë të jashtëm”.

Këto komente Osmani i bëri pas takimit në Shkup më 17 janar me ministrin për Evropë dhe Punë të Jashtme të Shqipërisë, Igli Hasani, i cili theksoi “rëndësinë e unifikimit jo vetëm si shqiptarë, por edhe të të gjitha fuqive progresive në rajon për të ardhmen e përbashkët të Ballkanit Perëndimor në familjen evropiane”.

Vlerësimet e Osmanit pasuan reagimet që po vazhdojnë në Maqedoninë e Veriut pasi partia në pushtet në Kosovë, Lëvizja Vetëvendosje (LV), ka vendosur të jetë pjesë e koalicionit të opozitës shqiptare në Maqedoninë e Veriut, që njihet me emrin Lidhja Evropiane për Ndryshim (LEN).

Kjo u bë e ditur më 24 dhjetor 2023 gjatë një ceremonie për hapjen e zyrave të opozitës në Shkup, ku ishin të pranishëm edhe përfaqësues të Lëvizjes Vetëvendosje.

Shefi i diplomacisë maqedonase, Bujar Osmani, që është edhe nënkryetar i Bashkimit Demokratik për Integritet (BDI), tha se “tëntime të tilla” ka pasur edhe më herët, ndërsa kujtoi rastin e Blerim Rekës nga Shkupi, të cilin opozita shqiptare e kishte caktuar kandidat për president të Maqedonisë së Veriut në zgjedhjet e vitit 2019, në tubimet e të cilat kishte pasur edhe përfaqësues të Lëvizjes Vetëvendosje.

Pas përfundimit të zgjedhjeve, Blerim Reka vazhdoi aktivitetin në Kosovë dhe më 3 shkurt 2020 ishte emëruar ministër i Integritetit Evropian në Qeverinë e udhëhequr nga lideri i Vetëvendosjes, Albin Kurti. “Kjo nuk është asgjë e re, pasi përpjekje të tilla për mbështetje direkte ka pasur edhe më parë, siç ishte rasti me një kandidat për president, i cili më pas ishte ministër në



Qeverinë e Kosovës. Nga eksponentë të lartë të Kosovës ai mori mbështetje në tubime dhe organizime të tjera. Por, kjo tregoi se skena politike e shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut është e konsoliduar. Dhe ashtu siç nuk ndikoi atëherë, nuk pres që në ndonjë mënyrë të ndikojë edhe tani”, tha kryediplomati Osmani. Pa saktësuar ndonjë emër të

partive politike, Osmani foli edhe për “tendencat nga jashtë për fragmentimin e skenës politike të Shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut në parti më të vogla politike” e që, sipas tij, “dobësojnë fuqinë e përfaqësimit të tyre të duhur në shtet”. “Fragmentimi i skenës politike shqiptare në parti më të vogla politike e dobëson fuqinë e përfaqësimit në mënyrë

të duhur në shtet sepse ka pasur një tendencë shpesh e nxitur edhe nga faktorë të jashtëm, por pak edhe nga dinamika e brendshme që shqiptarët në Maqedoninë e Veriut të organizohen në çdo qytet, të kenë parti politike, çdo qytet ta ketë liderin e vet politik dhe të merren me njëri-tjetrin, që të mos kenë një platformë të përbashkët politike, që në nivel

shtetëror i përfaqëson shqiptarët dhe ta përcjellë vullnetin e tyre politik në institucione”, u shpreh Osmani.

Veç kësaj, ai tha se praktikat e tilla nuk janë të mira, pasi “çdo legjitimitet i pjesëmarrjes së shteteve të tjera me partitë e tyre politike, përfshirë këtu edhe Serbinë, Bullgarinë, Shqipërinë, Kosovën e të tjerë, mund t’i lëkundë dinamikën e vendosura këtu, duke reflektuar te marrëdhëniet ndëretnike dhe ato politike”.

Më herët kishte reaguar edhe kryeministri i Maqedonisë së Veriut, njëherësh kryetari i Lidhjes Social Demokrate, Dimitar Kovačevski, duke u shprehur “i befashuar” pasi, sipas tij, në të kaluarën ka pasur raste kur parti të huaja mbështesnin parti simotra në zgjedhje të vendeve të tjera, por jo edhe të merrnin pjesë vetë në to. Lëvizja Vetëvendosje nuk është e regjistruar si subjekt politik në Maqedoninë e Veriut, por bashkëpunimi mes saj dhe tri partive opozitare - Lëvizjes Besa, partisë Alternativa dhe Lëvizjes Demokratike - pritet të konkretizohet me lista të përbashkëta për zgjedhjet parlamentare që do të mbahen më 8 maj të këtij viti në Maqedoninë e Veriut.

Sipas Kodit Zgjedhor të Maqedonisë së Veriut, në zgjedhje mund të marrin pjesë vetëm partitë e regjistruara në regjistrin qendror. Ndërsa lista zgjedhore mund ta përmbajë emrin e ndonjë koalicioni, siç është edhe Lidhja Evropiane për Ndryshim, por në brendi të saj duhet të theksohen emrat e partive politike që përbëjnë koalicionin.

Në listat për deputetë të koalicionit Lëvizja Evropiane për Ndryshim pritet të përfshihet Bekim Qoku, këshilltar i kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti.

Qoku më 24 dhjetor në Shkup, në tubimin e opozitës shqiptare, bëri me dije se Lëvizja Vetëvendosje do të jetë partia e katërt e koalicionit opozitar, me qëllim për të sjellë, siç tha ai, “ndryshimin e munguar” në Maqedoninë e Veriut.

William Walker: Unë besoj në drejtësi, por kjo nuk po ndodh në Gjykatën Speciale

PRISHTINË, 17 JANAR - Ish-ambasadori i OSBE-së, William Walker, është shprehur i zhgënjyer me gjykimin që është duke iu bërë krerëve të UÇK-së në Hagë.

Walker ka thënë se beson shumë në drejtësi por që, sipas tij, një gjë të tillë nuk po e sheh në Gjykatën Speciale. “Unë besoj shumë në drejtësi, në ndarje të drejtësisë, në llogaridhënie për shkak të

veprimeve, veçanërisht zyrtarët e lartë të qeverisë, por nuk më duket se kjo është çka po ndodh në Hagë. Me këta njerëz që i njoh, nuk mund të them që jam mik i tyre. Kam qenë kritik i madh i Hashim Thaçit kur ka qenë kryeministër dhe president. Nuk kam qenë kritik i madh i Kadri Veselit, por i kam thënë disa fjalë të vështira edhe atij. Jakup Krasniqin e kam njohur

mjaft mirë. Ka qenë njëfarë lloji si ndërlidhësi me UÇK-në kur përpiqeshim të kishim shkëmbim të të burgosurve apo lirim të gazetarëve”, ka thënë Walker.

Sipas tij, liderët e UÇK-së do të duhej të liroheshin me kusht. “Unë besoj që këta njerëz që i njoh do të duhej të liroheshin me kaucion, me kusht apo sido që quajnë atje në Hagë”, ka thënë ai. /Kanal10/





Në Mitrovicë të Veriut dhe Leposaviq nis peticioni për shkarkimin e kryetarëve shqiptarë

Në Mitrovicë të Veriut dhe Leposaviq të mërkurën ka nisur peticioni për shkarkimin e kryetarëve shqiptarë. Në vendet ku po grumbullohen nënshkrimet e qytetarëve ishin të pranishëm përfaqësuesit e Listës Serbe, e cila bojkotoi zgjedhjet dhe përfaqësuesit e saj u larguan nga institucionet e Kosovës dhe nxitën largimin edhe të serbëve të tjerë. Në mënyrë që peticioni të jetë i suksesshëm, kërkohet që të mbledhen të paktën 20 për qind e nënshkrimeve nga numri i përgjithshëm i votuesve të regjistruar. Qytetarët e komunave serbe në veri kanë afat për të mbledhur nënshkrime deri më 22 janar

MITROVICË E VERIUT, 17 JANAR - Në Mitrovicë të Veriut dhe Leposaviq nga e mërkura qytetarët mund ta nënshkruajnë peticionin për t'i shkarkuar kryetarët e komunave nga radhët e komunitetit shqiptar. Mbledhja e nënshkrimeve ka nisur të mërkurën në orën 09:00. Në rast se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) konfirmon rezultatin e peticionit, kjo do t'i hapte rrugë shkarkimit të kryetarëve shqiptarë në komunat në veri që u zgjodhën në prill të vitit 2023, pasi zgjedhjet u bojkotuan nga serbët në shenjë pakënaqësie me politikën e Qeverisë së Kosovës. Qytetarët e intervistuar nga Radio Evropa e Lirë në Mitrovicë të Veriut thanë se vendimi i serbëve për bojkotimin e zgjedhjeve lokale, megjithatë, ishte i gabuar. Peticioni është nënshkruar edhe nga përfaqësuesit e Listës Serbe,

parti që bojkotoi zgjedhjet dhe përfaqësuesit e saj u larguan nga institucionet e Kosovës dhe nxitën largimin edhe të serbëve të tjerë. Sipas gazetarëve të Radios Evropa e Lirë, në Mitrovicë të Veriut ka interesim të madh të qytetarëve për ta nënshkruar peticionin. "Jam e befasuar për të mirë dhe besoj se do ta përfundojmë këtë brenda dy ditësh", tha për Radion Evropa e Lirë, Sanja Kërtiniq, një nga nismëtares e peticionit, teksa komentoi interesimin e madh të qytetarëve për ta nënshkruar peticionin në Mitrovicë të Veriut. Në mënyrë që peticioni të jetë i suksesshëm, kërkohet që të mbledhen të paktën 20 për qind e nënshkrimeve nga numri i përgjithshëm i votuesve të regjistruar. Sipas KQZ-së, në Mitrovicën e Veriut duhet të mbledhen së paku 3 640 nënshkrime për shkarkimin

e kryetarit të komunës, pasi në listën zgjedhore janë regjistruar 18 199 persona me të drejtë vote. Në komunën e Leposaviqit të drejtë vote kanë 13 441 persona, që do të thotë se të paktën 2 689 prej tyre duhet ta nënshkruajnë peticionin për shkarkimin e kryetarit. Javën e ardhshme mbledhja e nënshkrimeve pritet të nisë edhe në Zveçan dhe Zubin Potok. Në Zubin Potok peticionit duhet t'i përgjigjen së paku 1 347 votues, që është 20 për qind nga 6 732 të votuesve të regjistruar. E në Zveçan, që peticioni të jetë i suksesshëm, duhet të nënshkruhet nga së paku 1 411 persona. Në vendet ku po grumbullohen nënshkrimet e qytetarëve ishin të pranishëm përfaqësuesit e Listës Serbe, partisë kryesore të serbëve në Kosovë e cila gëzon mbështetjen e Beogradit.

Sipas gazetarëve të REL-it, në krye të radhëve të gjata të qytetarëve në Mitrovicë të Veriut ishte kryetari i kësaj partie, Zllatan Ellek. Aty u panë edhe zyrtarët e kësaj partie, Igor Simiq dhe Millan Radojeviq, ish-kryetari i Mitrovicës së Veriut. Po ashtu, i pranishëm ishte edhe Goran Rakiq, ish-udhëheqësi i Listës Serbe, i cili ishte në listën e kandidatëve nga radhët e Partisë Progresive Serbe (SNS) për deputetë në Kuvendin e Serbisë. Reporteri i REL-it raportoi se në Leposaviq, në vendin ku po mbledhen nënshkrimet për peticionin, ishte i pranishëm edhe Zoran Todiq nga Lista Serbe, i cili më parë ka udhëhequr këtë komunë.

Lista Serbe kishte iniciuar largimin e serbëve nga institucionet e Kosovës në nëntor të vitit 2022 dhe më pas kishte bërë thirrje për bojkotimin e zgjedhjeve të prillit të vitit të kaluar. Largimi nga institucionet u bë në shenjë pakënaqësie ndaj vendimit të Qeverisë së Kosovës lidhur me ndërrimin e targave të makinave nga ato të lëshuara nga Serbia në ato që lëshohen nga Kosova, por që atëherë kjo çështje është zgjidhur. Mirëpo, në mesin e tetorit të vitit 2023, kjo parti deklaroi se ishte e gatshme të merrte pjesë në zgjedhjet në

komunat në veri, pa vendosur asnjë kusht për pjesëmarrje në zgjedhje, siç kishte bërë më herët. Ky qëndrim i kësaj partie u mor pasi presidenti serb, Aleksandar Vuçiq, u bëri thirrje përfaqësuesve serbë në veri të Kosovës që ta inicionin mbajtjen e zgjedhjeve të reja në mënyrë që "levat kryesore të pushtetit të jenë në duart e tyre".

Kësaj thirrjeje i parapriu një sulm i armatosur në Banjskë të Zveçanit më 24 shtator, kur një grup serbësh sulmuan Policinë e Kosovës duke vrarë një polic. Përgjegjësinë për sulmin e mori ish-nënkryetari i Listës Serbe, Millan Radoiçiq.

Thirrje për nënshkrimin e peticionit

Në Mitrovicë të Veriut peticioni po mbahet pasi asamblistët komunalë miratuan kërkesën e iniciatorit që mbledhja e nënshkrimeve të bëhet në sallën e sportit në këtë komunë në veri të Kosovës, të banuar me shumicë serbe.

Ndërkaq në Leposaviq, sipas njërit nga iniciatorët e peticionit, Vesellin Radoviq, është marrë leje që të shfrytëzohet hapësira para komunës për mbledhjen e nënshkrimeve.

Konjufca paralajmëron zgjedhje të jashtëzakonshme

PRISHTINË, 17 JANAR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka paralajmëruar zgjedhje të jashtëzakonshme në vendin tonë.

Gjatë homazheve në përkujtim të Kadri Zekës, Konjufca për lajmi.net ka thënë se është për mbajtje të zgjedhjeve. "Ne jemi të

përgatitur për zgjedhje. Edhe unë jam për zgjedhje. LV-ja është për zgjedhje", ka thënë Konjufca.

Sipas Konjufcës, në një shtet demokratik partitë politike duhet të jenë të gatshme çdoherë për zgjedhje.

Fundi i vitit 2024 ose fillimi i vitit 2025 do të jetë vit i zgjedhjeve të

rregullta parlamentare në Kosovë. Albin Kurti ka marrë mandatin qeverisës më 22 mars të vitit 2021. Pra, Kuvendi i Kosovës është konstituuar më 22 mars 2021 dhe mandati fillon nga dita e konstituimit, që do të thotë mandati i kësaj legjislature përfundon më 22 mars 2025.

Sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, zgjedhjet e rregullta parlamentare nuk mbahen më herët se 60 ditë dhe jo më vonë se 30 ditë para përfundimit të mandatit. Duke iu referuar këtij ligji, sipas kompetencave të presidentit të përcaktuara me Kushtetutë, shefi

i shtetit cakton datën e zgjedhjeve jo më herët se gjashtë muaj dhe jo më vonë se katër muaj para datës së zgjedhjeve.

Në fillim të këtij viti janë shtuar zërat nga opozita dhe nga pushteti për mundësinë e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare.



Sanja Kërtiniq, një nga nismëtares e kërkesës për nisjen e peticionit në Mitrovicë të Veriut, përmes medieve paraprakisht njoftoi qytetarët që të marrin me vete dokumentet e nevojshme për nënshkrimin e peticionit. Ajo i ftoi qytetarët ta nënshkruajnë kërkesën për shkarkimin e kryetarit aktual të komunës, duke u bërë thirrje edhe drejtorëve të institucioneve që financohen nga Serbia dhe punonjësve të këtyre institucioneve, që kanë vendbanim në Mitrovicë të Veriut, t'i marrin me vete letërnjoftimet dhe ta nënshkruajnë peticionin.

Sipas disa burimeve të Radios Evropa e Lirë, mesazhe me thirrje të tilla për nënshkrimin e peticionit u janë dërguar

punëtorëve të Qendrës Klinike Spitalore në Mitrovicë të Veriut, mësimdhënësve, punëtorëve të institucioneve komunale që punojnë sipas sistemit serb, si dhe atyre që janë larguar nga institucionet e Kosovës më 2022, por që tani paguhen nga buxheti i Serbisë.

Radio Evropa e Lirë ka mësuar se drejtuesit e institucioneve paralele u kanë thënë punëtorëve që janë në pushime dimërore dhe nuk gjenden në Mitrovicë të Veriut, se mund ta nënshkruajnë peticionin deri më 21 janar.

Kryetarët në katër komunat në veri të Kosovës, që banohen me shumicë serbe - Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok - janë shqiptarë, pasi partitë dhe popullata serbe

bojkotoi zgjedhjet lokale të vitit të kaluar.

Nënshkrimet për largimin e tyre tani po mbledhen në bazë të Udhëzimit Administrativ të Qeverisë së Kosovës, i cili është miratuar në fillim të shtatorit 2023.

Baza ligjore për largimin e kryetarëve të komunave

Sipas Udhëzimit Administrativ për shkarkimin e udhëheqësit të komunës, një grup qytetarësh, pas marrjes së autorizimit për të shfrytëzuar një zonë publike apo vend për të nisur një peticion, kanë 30 ditë kohë për t'i mbledhur nënshkrimet për

shkarkimin e kryetarit. Ky afat mund të zgjatet vetëm një herë deri në 15 ditë.

Mirëpo, ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, deklaroi javën e kaluar se qytetarët e Mitrovicës së Veriut, Leposaviqit dhe Zubin Potokut kanë afat për t'i mbledhur nënshkrime deri më 22 janar. Ai shtoi se afati për qytetarët e komunës së Zveçanit është më i gjatë për rreth pesë ditë për shkak se në KQZ është dorëzuar më vonë kërkesa për ta ditur numrin e saktë të votuesve të regjistruar.

Nëse KQZ-ja konfirmon se nënshkrimet e mbledhura janë aq sa kërkohet dhe i verifikon ato, më pas organizohet votimi për shkarkimin e kryetarit, i cili duhet

të mbahet brenda 45 ditësh. Që ky votim të jetë i suksesshëm, duhen 50 për qind, plus një votë e qytetarëve me të drejtë vote.

Pas kësaj, rezultati i dërgohet presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, e cila ka afat ligjor prej 30 deri në 45 ditë për ta shpallur mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme.

Nisja e detyrës së kryetarëve shqiptarë në komunat në veri nxitu tensione në fund të majit të kaluar, tensione që kulmuan në Zveçan, pasi protestuesit serbë u përleshën me pjesëtarët e misionit paqeruajtës të NATO-s në Kosovë, KFOR.

Bashkësia ndërkombëtare ka kërkuar uljen e tensioneve dhe shpalljen e zgjedhjeve të reja në katër komunat në veri të Kosovës.

Osmani dhe Konjufca bëjnë homazhe te varret e Jusuf dhe Bardhosh Gërvallës në Dubovik

DEÇAN, 17 JANAR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, së bashku me kryetarin e Kuvendit, Glauk Konjufca dhe zëvendëskryeministren dhe ministren e Punëve të Jashtme, Donika Gërvalla, kanë bërë homazhe te varret e Jusuf dhe Bardhosh Gërvallës në Dubovik të

Deçanit. “Në guximin e tyre e gjejmë frymëzimin, në sakrificën e tyre, heroizmin. Në 42-vjetorin e vrasjes sot nderojmë tri personalitete të guximshme, të cilat ishin cak i një atentati politik. Me veprën e tyre ata u përjetësuan në heronj. Jusuf e Bardhosh Gërvalla, bashkë

me Kadri Zekën, ndoqën rrugën e së vërtetës, nderit dhe lirisë! Të tre kolosët punuan me nder, ndaj sot e përherë do të jenë të nderuar nga ne dhe brezat që do të vijnë. Qoftë i përjetshëm kujtimi për Jusufin, Bardhoshin dhe Kadriun!”, ka thënë Osmani.



Në Gjilan zbulohet shtatorja e heroit Kadri Zeka



GJILAN, 17 JANAR - Në 42-vjetorin e rënies heroike, të mërkurën në Gjilan është bërë zbulimi i shtatores së heroit Kadri Zeka. Në zbulimin e kësaj shtatore morën pjesë përfaqësues nga pushteti lokal, ai qendror, deputetë të Kuvendit të Kosovës, përfaqësues nga Lugina e Preshevës, kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, kryetari i BDI-së, Ali Ahmeti, kryetari i Kuvendit të Maqedonisë së Veriut, Talat Xhaferi, udhëheqësi i Qendrës “Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur”, Bardhyl Mahmuti, veprimtarë dhe qytetarë të shumtë. Ramush Haradinaj ka thënë se sot Kadri Zeka u shndërrua në bronz në mes të qytetit prej ku i

bënë roje Gjilanit të Mulla Idrizit e Idriz Seferit, të Agim Ramadanit e të shumë heronjve e dëshmorëve nga kjo trevë. Haradinaj ka thënë se rruga drejt lirisë nuk u ndal asnjëherë. “Dora e armikut ishte kudo në ndjekje të shqiptarëve, sepse armiku kishte kuptuar saktë se rreshtimi ynë në anën e drejtë të historisë ishte në rrugë të pakthyeshme, i vendosur dhe i drejtë, prandaj nuk kursente asgjë për ta ndalë e shuar përpjekjen tonë. Rruga drejt lirisë nuk u ndal asnjëherë. Ishte nisur qysh herët, vazhdoi me Jusufin e Bardhoshin krah Kadriut, kulmoi me luftën tonë çlirimtare duke sjellë lirinë për Kosovën”, ka thënë Haradinaj.

Me rregulloren e re të “Prishtina Parking”, rreth 2 000 qytetarë do të rimbursohen

PRISHTINË, 17 JANAR - “Prishtina Parking” do ta implementojë rregulloren e re të parkimit që nga 22 janari i këtij viti. Kjo ndërmarrje ka njoftuar se si rezultat i hyrjes në fuqi të rregullores së re, do të rimbursojë 1 862 qytetarë të cilët janë në parapagim në vlerë prej 44 130 eurosh. “Qytetarët që janë në parapagim do të rimbursohen përgjatë procesit të regjistrimit të veturave të para pranë ndërmarrjes ‘Prishtina Parking’”, thuhet në njoftimin për medie.

Rregullorja e re parasheh një sërë ndryshimesh që prekin mënyrën e parkimit në kryeqytet. Sipas detajeve të dhëna nga “Prishtina Parking”, tashmë banorët rezidentë do të përfitojnë nga parkimi falas për mjetin e tyre të parë në rrugën ku jetojnë, pasi të kenë kryer një



regjistrim të kodifikuar për tërë qytetin, i cili ka një tarifë njëherëshe prej 10-eurosh. Për mjetin e dytë tarifa do të jetë

më e lirë, 10 euro për muaj. Në mes të ndryshimeve të tjera të rëndësishme, laurat do të hiqen nga lagjet rezidenciale

dhe do të zgjatet orari i parkimit në Zonat 1 dhe 2 deri në orën 23:00. Banorët rezidentë do të kenë

përparësi në procesin e regjistrimit përpara subjekteve juridike dhe lokaleve të biznesit dhe parkimi do të jetë falas gjatë ditëve të shtunë dhe të diel në hapësirat e parkimit të hapura. Njoftimi përfshin edhe informacion se si do të funksionojë sistemi i rimbursimit për parapagimet e bëra për periudhën pas datës 22 janar, ku përfshihet një zbritje prej 10-eurosh që do të aplikohet si pagesë administrative. Ajo që e bën këtë rregullore edhe më transparente është procedura e trajtimit të ankesave dhe mundësia e publikimit të përgjigjeve në rast se kërkohet nga ankuesi. Të gjitha parkingjet tani do të kenë sinjalistikë horizontale dhe vertikale që përmban informata të plota për kufizimet dhe të drejtat.

Ministri i Jashtëm i Shqipërisë në Shkup: Po forcojmë bashkëpunimin në integrim dhe siguri

SHKUP, 17 JANAR - Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë, Igli Hasani, ka takuar të mërkurën në Shkup ministrin e Jashtëm të Maqedonisë së Veriut, Bujar

Osmani, me të cilin kanë diskutuar për hapa konkretë për ta forcuar bashkëpunimin në projekte kryesore si Korridori VIII, integrimin dhe sigurinë.

“Angazhimi ynë i palëkundur ndaj këtyre iniciativave, në dobi të vendeve dhe njerëzve tanë, mbetet prioritet kryesor. Rikonfirmuam se lidhjet e shkëlqyera bilaterale

dhe multilaterale ndërmjet vendeve tona shërbejnë si model pozitiv për Ballkanin Perëndimor dhe procesin tonë të integritetit për në BE”, ka thënë Hasani.



O'Brien gjatë takimit me Kurtin vlerëson përparimin ekonomik dhe demokratik të Kosovës

PRISHTINË, 17 JANAR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, është takuar me Ndihmëssekretarin amerikan të Shtetit për Evropën dhe Euroazinë, James O'Brien, në margjina të Forumit Ekonomik që po mbahet në Davos të Zvicrës. Sipas njoftimit të Qeverisë së Kosovës, u theksua angazhimi

dhe përkushtimi për fuqizimin e bashkëpunimit dhe thellimin e marrëdhënieve tona. "Biseda më tej u fokusua në aktualitetin në vend dhe rajon. Si partnerë dhe aleatë, jemi gjithmonë të bashkërenduar dhe në komunikim të vazhdueshëm. Zëvendëssekretari O'Brien vlerësoi përparimin ekonomik dhe demokratik të Kosovës dhe

vetëpërmbytjen e institucioneve të Republikës së Kosovës pavarësisht prej provokimeve dhe sulmeve në veri të vendit. Kryeministri Kurti e falënderoi zëvendëssekretarin O'Brien për bisedën dhe mbështetjen e vazhdueshme të tij dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës", ka njoftuar Qeveria e Kosovës.



Në Fakultetin Juridik themelohet Qendra për Studimin e Gjenocidit, Holokaustit dhe Drejtësisë Tranzicionale

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 17 JANAR - Në dhjetor 2023, në kuadër të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës, është themeluar "Qendra për Studimin e Gjenocidit, Holokaustit dhe Drejtësisë Tranzicionale". Bazuar në programin e Fakultetit Juridik për adresimin e të kaluarës nga perspektiva akademike (pas fillimit të zbatimit të programit unik master në gjuhën angleze "Human Rights, International Criminal Law and Transitional Justice"), me kërkesë të dekanit dhe mbështetjen e rektorit të UP-së, vendimi për themelimin e Qendrës është marrë nga Këshilli Drejtues. Qendra për Studimin e Gjenocidit, Holokaustit dhe Drejtësisë Tranzicionale do të ketë një program unik të funksionimit me fokus në hulumtimin dhe studimin e krimit të gjenocidit (pa përjashtuar krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit dhe agresionit), holokaustit (si krimet që në historinë botërore përbëjnë edhe shkakun e krijimit të instrumenteve ndërkombëtare për normimin e krimeve me të rënda dhe mekanizmave për gjykimin e personave përgjegjës), si dhe avancimin e hulumtimeve dhe edukimit nga fusha e drejtësisë tranzicionale, për të arritur rezultate sa me të larta në



adresimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut. Përveç dimensionit primar hulumtues dhe akademik që do ta ketë kjo qendër në kuadër të Fakultetit Juridik, për shkak të historisë sonë si popull është legjitime dhe shumë humane të presim që pjesa tjetër që ndërlidhet me të kaluarën e krimeve të luftës dhe krimeve të tjera kundër njerëzimit, do të adresohet nga institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës. Duke njohur këtë realitet ekzistues, përtej përgjegjësisë së institucioneve shtetërore (që

mbetet në vullnetin dhe kompetencat e bartësve të tyre), themelimi i "Qendrës për Studimin e Gjenocidit, Holokaustit dhe Drejtësisë Tranzicionale" në Fakultetin Juridik, nënkupton adresimin nga aspekti akademik, hulumtues, edukativ dhe kulturor i të kaluarës në lidhje me krimet më të rënda, përfshirë krimin e gjenocidit. Qendra pritet të ketë bashkëpunim me institucionet e Republikës së Kosovës (Qeverinë/Ministrinë e Drejtësisë, Kuvendin), komisionet dhe trupat që do t'i

trajtojnë këto çështje, si dhe me autoritetet e drejtësisë, në funksion të bashkërendimit të aktiviteteve dhe ndihmës së ndërsjellë, gjithmonë brenda kompetencave dhe natyrës së fushëveprimit. Fakulteti Juridik në vitin 2023 ka akredituar edhe programin e ri master në gjuhë angleze "Human Rights, International Criminal Law and Transitional Justice", i cili është një program unik në rajon, i cili në përmbajtjen e tij trajton të drejtat themelore të njeriut, krimet ndërkombëtare (gjenocidin, krimet e luftës, krimet kundër

njerëzimit etj.), jurisprudencën e gjykatave/tribunaleve penale ndërkombëtare, të drejtat e viktimave dhe procesin e drejtësisë tranzicionale. Si i tillë, ky program ka filluar në këtë vit akademik, e përveç studentëve vendorë, janë pranuar edhe 10 studentë ndërkombëtarë, që njëherësh janë edhe studentët e parë ndërkombëtarë të rregullt (full time). Gjithashtu, përveç profesorëve të Fakultetit Juridik, në mbajtjen e ligjëratave për lëndët e këtij programi janë të angazhuar edhe profesorë ndërkombëtarë nga universitetet prestigjioze.

Kroacia nis ushtarë në Kosovë

PRISHTINË, 17 JANAR - Në mesin e njoftimeve se Kosova do të blejë raketa antitanke "Javelin" nga ShBA-ja dhe pas shtimit të ndjeshëm të shpenzimeve të mbrojtjes nga Serbia, Ministria e Mbrojtjes e Kroacisë ka njoftuar se do të nisë një kontingjent të ri ushtarësh për ta forcuar misionin e NATO-s në Kosovë. Lëvizja e saj vjen në mesin e frikës për një përshkallëzim të ri të mundshëm të situatës, të cilën komuniteti ndërkombëtar kërkon ta shmangë me çdo kusht. Sipas njoftimit, bëhet fjalë

për regjimentin e dytë të forcave ajrore kroate, që do t'i bashkohet misionit kroat të KFOR-it. "Komandant i regjimentit të forcave është majori Elvis Mishiç, një kapiten i skuadrës së 395-të të helikopterëve në kuadër të Forcave Ajrore të Kroacisë", thuhet nga Ministria e Mbrojtjes e Kroacisë. Për majorin Mishiç, ky është udhëtimi i gjashtë në kuadër të operacionit të KFOR-it. Mediet në Kosovë shkruajnë se përpara nisjes, ai deklaroi se pjesëtarët e regjimentit të

aviacionit janë të përgatitur mirë dhe të gatshëm për t'i kryer të gjitha detyrat dhe se përfaqësojnë me profesionalizëm dhe nder ushtrinë kroate dhe Kroacinë. "Detyra kryesore e kontingjentit kroat në operacionin e mbështetjes së paqes KFOR, që është i vendosur në zonën e aeroportit të Sllatinës në Prishtinë, është transporti i forcave të KFOR-it, mallrave dhe personave VIP", nënvizohet në deklaratën e Ministrisë së Mbrojtjes së Kroacisë.



Trusti përmbyll vitin 2023 me rritje rreth 90 milionë euro

EPOKA E RE**Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 17 JANAR - Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës ka njoftuar se ka përmbyllur vitin 2023 me +87.7 milionë euro kthim bruto nga investimet. “Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës e përmbylli vitin 2023 me +87.7 milionë euro kthim bruto nga investimet. Ky ishte viti i 19 nga gjithsej 22 vjet të operimit, ku institucioni del me rezultat pozitiv nga investimi i kursimeve pensionale. Kjo shpui në +750 milionë euro kthim të gjithëmbarshtëm bruto prej themelimit. Arkëtimi i kontributeve të reja në 2023-shin, në vlerë 286 milionë euro, pasqyron një rritje rekorde krahasuar me vitin paraprak si në vlerë nominale (+44 milionë euro), por edhe si përqindje (+18.2 për qind). Kontributet e reja, bashkë me kthimin në investime, ndryshe nga tërheqjet

e kursimeve dhe tarifat, kanë kontribuar pozitivisht që mjetet neto nën menaxhim të FKPK-së të rriten sivjet për +291 milionë euro dhe kështu tejkalojnë vlerën e 2.7 miliardë eurove”, ka njoftuar Fondi i Kursimeve Pensionale. Në njoftim theksohet se performanca e investimeve për Portofolin Standard për vitin 2023 ishte +3.05 për qind (2022: 75.54 për qind; 2021: +10.65 për qind). “Synimi i këtij portofoli është që në afat të gjatë ta tejkalojë indeksin e çmimeve të konsumit (ndryshe inflacionin) në Kosovë. Aktualisht çmimi i njësisë së këtij portofoli është ngritur për 67.6 për qind prej themelimit, ndërsa inflacioni në Kosovë për 70.2 për qind. Bordi Drejtues, i emëruar në detyrë prej 13 korrikut 2023, e ka ruajtur përgjithësisht qasjen e ndërmarrjes së riskut të ulët në investimet e Portofolit Standard nga Bordi paraprak, meqë gjendja e përgjithshme ekonomiko-financiare dhe gjeopolitike ishte



dukshëm e ngarkuar nga ngjarje me potencial të lartë të ndikimit negativ në performancën investuese. Kjo qasje pritet të rishikohet gjatë vitit 2024”, ka njoftuar Fondi i Kursimeve Pensionale. Ndërkaq në Portofolin Konservativ kishte ngritje prej +3.47-përqindësh të çmimit të njësisë për vitin 2023 (2022: +2.94 për qind). “Për shkak se investimet e këtij portofoli janë

vetëm në fletobligacionet e Qeverisë së Kosovës, ato nuk ndikohen nga ndryshimet në tregjet financiare, rrjedhimisht kanë stabilitet më të lartë. Kthimi bruto i këtij portofoli nga fillimi (shkurt 2022) ka arritur në 5.1 milionë euro. Qëllimi i këtij portofoli është që ta ruajë vlerën e kursimeve pensionale nga lëvizjet në tregjet financiare të kontribuuesve që janë shumë afër pensionimit dhe nuk mund

të kenë kohë të mjaftueshme të rikuperimit nga luhatjet e forta negative në tregjet financiare globale”, thuhet në njoftimin e FKPK-së. Sa i përket pritshmërisë për vitin 2024, sipas Fondit të Kursimeve Pensionale, ekziston një vlerësim që ngritja e përgjithshme ekonomike globale për vitin 2024 do të jetë rreth 2.4 për qind. “Ky parashikim vlerëson se kështu do të jetë viti i tretë rresht që ekonomia globale do të ketë regres në ngritjen ekonomike. Nën këto kushte, dhe në vlerësim të rreziqeve gjeopolitike në rritje, Bordi Drejtues i FKPK-së pritet t'i vazhdojë vendimet investuese që ndërmarrin risk të moderuar investues. Gjithsesi se vendimi më i rëndësishëm i vitit në vijim do të jetë inicimi i zbatimit të portofolit të tretë investues, për të cilin do të ketë njoftime të detajuara para fillimit të tij”, theksohet në njoftimin e FKPK-së.

Kurti viziton Panairin Ndërkombëtar “Swiss Bau 2024”, sheh nga afër prodhimet e kompanive nga Kosova



PRISHTINË, 17 JANAR - Panairi Ndërkombëtar “Swiss Bau 2024”, në Basel të Zvicrës, ka hapur dyert për vizitorë, në të cilin kompanitë nga Kosova po ekspozojnë prodhimet e tyre të drurit dhe të ndërtimtarisë. Panairi nisi me vizitën e kryeministrit Albin Kurti dhe ministres së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, te bizneset vendore. Kryeministri Kurti tha se përparimi në demokraci dhe qeverisje dhe stabiliteti institucional kanë reflektuar me rritje të dukshme të eksporteve dhe me investime të huaja. Ndërkaq ministrja Hajdari theksoi se industria e drurit është një ndër sektorët strategjik për zhvillimin ekonomik të Republikës së Kosovës sepse ka potencial për t'i rritur përfitimet e brendshme nga përdorimi i

resurseve vendore dhe është ndër të vetmit sektor industrial që ka kontribut pozitiv për rritjen e inovacionit dhe uljen e deficitit tregtar. Kurti dhe Hajdari, duke vlerësuar lart kontributin e vazhdueshëm të diasporës, bënë thirrje që investimet e tyre potenciale t'i orientojnë në Kosovë, duke i siguruar ata për mundësitë dhe përparësitë që ofrohen përmes reformave të ndërmarrja nga qeveria, të cilat mbrojnë dhe trajtojnë barabartë investimet e diasporës dhe ato të huaja. Panairi “Swiss Bau 2024” do të mbahet deri më 19 janar në Basel. 12 kompani vendore të mbështetura nga Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) po ekspozojnë produktet e tyre.

Rukiqi i reagon Kurtit: Kemi 101 milionë euro më pak eksporte në vitin 2023

PRISHTINË, 17 JANAR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në panairin “Swissbau 2024” ka deklaruar se Kosova ka rritje të dukshme të eksporteve dhe investimeve të huaja. Kurti tha se vetëm në tre vitet e fundit vlera e eksportit të Kosovës ka arritur rreth 2.5 miliardë euro. Ndaj këtyre deklaratave të Kurtit ka reaguar anëtar i Kryesisë së LDK-së, Berat Rukiqi. “101 milionë euro më

pak eksporte në vitin 2023. 4.84 miliardë euro deficit tregtar i vitit 2023. 920 milionë e 405 mijë euro ishin eksportet e Kosovës në vitin 2022. 819 milionë e 64 mijë euro ishte vlera e mallrave të eksportuara në vitin 2023. Plot 101 milionë euro më pak eksport në krahasim me vitin paraprak”, ka shkruar ai në “Facebook”, duke theksuar se kjo rënie drastike në eksport dhe thellimi i deficitit tregtar (rreth 2 miliardë

më shumë në dy vitet e fundit) janë shpërfaqje evidente e dështimit të kësaj qeverie në qeverisjen me ekonominë e vendit. Ai ka thënë se ka indikacione të qarta nga tregu se rënia e eksporteve në vitin 2023, mes të tjerash, është rezultat edhe i sanksioneve të cilat na erdhën si rezultat i përplasjes direkte të kësaj qeverie me aleatët. “Të tjerët duhet të na lakmojnë për këto ‘rekorde’”, ka deklaruar Rukiqi.



FJALIM NË INAUGURIMIN E SHTATORËS SË HEROIT TË KOMBIT KADRI ZEKA

KADRI ZEKA IDEOLOG I BASHKIMIT TË DIASPORËS SHQIPTARE

Ismet SYLEJMANI

*E dashur familje e Heroit të Kombit Kadri Zeka!
I nderuar Kryetar i Komunës së Gjilanit Alban Hyseni!
E nderuara Ministre e Drejtësisë znj. Albulena Haxhiu!
I nderuar Udhëheqës i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti!
I nderuar Kryetar i Parlamentit e Kryeminister i ardhshëm i Maqedonisë së Veriut Talat Xhaferi!
I nderuar ish- Kryeminister Ramush Haradinaj!
Te nderuar deputet e ish -deputet të parlamentit nga Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Lugina e Presheves!
I nderuar Zv. Minister i Mbrojtjes Shemsi Sylaj!
I nderuar ish- Komandant i Zonës Ahmet Isufi!
Të dashura familje të Heronjëve dhe Dëshmorëve të Kombit!
Të dashur invalid, të nderuar ish - të burgosur politik, veprimtar të Lëvizjes Popullore të Kosovës, veteran ushtar e veteran komandant të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës!*

Të nderuar të pranishëm!
Qyteti i Gjilanit sot, më 17 Janar 2024, me vendosjen edhe të shtatit të derdhur në bronz të Heroit të Kombit Kadri Zeka, përfundimisht po bëhet edhe më i shtrenjtë dhe më i shenjtë për kombin!
Udhëheqësi i lavdishëm, organizatori i guximshëm trim dhe sypatrembur, luani historik i diasporës besnike shqiptare, Anëtar i Komitetit Drejtues të GMLK-së, njëri prej Redaktorëve e Kryeredaktorëve të gazetës së famshme ilegale politiko-patriotike “LIRIA”, njëri prej hartuesve kryesor të Tezave Rreth Frontit Popullor, Ai që iu vërsul pamshirshëm propagnadës jugosllave në perendim dhe e shpartalloi, Heroi i Kombit Kadri Zeka, sot po vendoset vertikalisht i derdhur në bronz në qytetin e Tij të pjekurisë së madhe politike dhe të ngritjes së hovshme e revolucionare në Gjilanin e papmposhtur, qytet ky i cili kurrë




nëpër histori nuk u përkul, por qëndroi si një nga qytetet më të mëdha të Kosovës, që i dha gjithëçka popullit dhe renditet në mesin e Kryeqyteteve të Krahinave të Atdheut të panënshtuar, me ndikim absolut në platformen për çlirim e përparim të Kombit tonë! Në veprimtarinë tonë ilegale politiko-patriotike, bashkë me Heroin e Kombit, shokun e bashkëveprimtarin tim Xhevat Qerimi dhe më vonë edhe bashkë me Heroin e Kombit, shokun e bashkëveprimtarin tim Tefik Zymberi, dhe me shumë shokë të tjerë të gjallë me kontribute të shquara, e kishim për obligim e për detyrim kombëtar, e kishim përgjegjësi por edhe e kishim fat, që ishim ngarkuar dhe zgjedhur, të drejtonim në Lëvizjen Popullore të Kosovës dhe ta vazhdonim rrugën Tuaj, Udhëheqësi ynë i madh Kadri Zeka, dhe ia dolëm të jemi fitimtar, të lirë e të pavarur!
Më 17 Nëntor 1994, në Zvicërr, atje ku Ti bashkë me Jusuf e Bardhosh Gërvallen, shkëlqeve me madhështi të jashtëzakonshme, si asnjë tjetër, duke ia vënë bazat e shëndosha veprimtari ilegale jashtë

Atdheut, shokët dhe vazhduesit e veprimtarisë Tënde, Udhëheqës në Lëvizjen Popullore të Kosovës, edhe de jure e themeluan në Arau, Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, e cila e stervitur dhe e përkrahur nga Nëna Shqipëri, luftoi heroikisht kundër Serbisë pushtuese dhe e ndihmuar nga aleati ynë i madh Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e bëri realitet endrrën Tënde, të shokëve e bashkëveprimtarëve Tuaj, të qindra dhe mijëra Heronjëve e Dëshmorëve të UÇK-së, që e derdhën gjakun lum dhe të luftëtarëve heroik, ushtar e komandant lavdimdhenj, trima e sypatrembur, që luftuan dhe e çliruan Kosovën nga çizmjat pushtuese serbe dhe tradhtarë!
Ne veprimtarët e Lëvizjes Popullore të Kosovës - LPK, pasardhësit besnik e të pa dilema në rrugën Tënde, në luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e kishim për obligim që Brigadën e parë të Zonës Operative të Karadakut, ta emronim me emrin Brigada 171 “Kadri Zeka”, dhe të rreshtoheshim e ta kishim në ballë flamurin që mbante emrin Tënd të pavdekshëm!

I dashur Udhëheqësi ynë Kadri Zeka!
Lëvizja Popullore e Kosovës, në themelet e së cilës ishte gjaku, djersa dhe aktiviteti Yt i madh, nuk e ndali aktivitetin e saj edhe pas çlirimit nga Serbia pushtuese të Kosovës, Ajo në vitin 2000 e themeloi UÇPMB-në në Luginë të Presheves dhe në vitin 2001 e themeloi Ushtrinë Çlirimtare Kombëtare në Maqedoni të Veriut!
Të tri ushtritë çlirimtare të dalura nga brumi i LPK-së, bënë realitet pjesë të mëdha nga Platforma Jote, dhe Ti i madhi i pavdekshëm Kadri Zeka, duhet të jeshë i qetë e i lumtur në shtartin e lavdisë së përjetshme!
Të nderuar të pranishëm!
Heroi i madh i popullit, Atdheut e Kombit tonë Kadri Zeka, bashkë me Simbolin e Bashkimit me Shqipërinë, Heroin e Kuvendit të Kosovës në Prizren Ramiz Cernicën, u dasht të kalonin 25 vite pas çlirimit, dhe erdhën të fundit në permendore, ndonëse duhej të vinin të parët!
Përsëri gjej rastin, ta falënderoj Kryetarin e Komunës Alban Hysenin, sepse në mandatin e parë të udhëheqjes së Tij Ky e solli Ramiz

Cernicën dhe ja sot, këtu e solli edhe Kadri Zeken!
Por i dashur dhe i nderuar Kryetar Alban Hyseni, të kanë mbetur me i shkrire në shtatore në bronz edhe tre Heronj të Kombit!
Është nga Gjilani, Heroi i Kombit Zija Shemsiu, i vetmi shqiptar nga Kosova, i mbytur në torturë në vitin 1985 në Burgun Qendror në Beograd, është Komandanti i njësiteve të para të UÇK-së i stervitur në Shqipëri bashkë me Zahir Pajazitin, Heroi i Kombit Xhevat Qerimi dhe është Heroi i Kombit e Heroi i Universitetit të Tetovës Alban Ajeti!
Bëji edhe këta tre, bashkë me Idriz Seferin, Mulla Idrizin, Ramiz Cernicën, Kadri Zeken, Rexhep Malen, Nuhi Berishen, Agim Ramadanin, Abdullah Tahirin, Heroinat etj., sepse Gjilani e meriton, dhe duhet të stoliset me shtatore truallë i tij me bijtë dhe bijat besnike që i kanë dalur zot nëpër histori!
Lavdi të pavdekshmit Kadri Zeka!
Lavdi Heronjëve dhe Dëshmorëve të Kombit!
Gjilan, 17 Janar 2024!





Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Federata e Xhudos, kamp përgatitor me xhudistë në Pejë

PEJË, 17 JANAR - Federata e Xhudos së Kosovës kohë pas kohe po mban kampe të ndryshme për zhvillimin dhe masivizimin e këtij sporti. Një të tillë këto ditë po e organizon në Qendrën Nacionale të Xhudos në Pejë, ku po përgatiten të gjitha klubet e xhudos së Kosovës. Ky kamp ka

nisur më 15 janar dhe do të zgjasë deri me datën 19, respektivisht deri të premten. "Pjesëmarrësit në këtë kamp do të marrin pjesë në Kampionatin e Kosovës për seniorë me datë 20 janar, si dhe do të përgatiten dhe përzgjedhen për pjesëmarrje në gara ndërkombëtare për

kadetë, juniorë dhe seniorë", ka njoftuar Federata e Xhudos. Ky është një vit mjaft i rëndësishëm për sportin më të suksesshëm në Kosovë pasi do të mbahet gara më prestigjioze e këtij sporti, respektivisht Olimpiada e Parisit, ku xhudistët e Kosovës do të synojnë medalje olimpike.



Duka: Tifozët tanë do ta 'skuqin' Gjermaninë

TIRANË, 17 JANAR - Presidenti i Federatës Shqiptare të Futbollit, Armand Duka, gjatë një interviste për "Sportpress24", ka folur edhe për fazën finale të Kampionatit Evropian "Euro 2024". Ai ka thënë se tifozët kuqezijë do ta "skuqin" Gjermaninë. "Mezi pres që lojtarët, stafi e tifozët ta shijojnë pjesëmarrjen në Euro, ta shijojnë suksesin e tyre. Futbollistët nuk duhet të kenë asnjë lloj ngarkese. Ata e kanë bërë detyrën: na kanë bërë krenarë me pjesëmarrjen në Euro. Atë që nuk e kishim provuar e shijuar kurrë në histori po e shijojmë për herë të dytë në

harkun e tetë viteve. Ne nuk duhet të bëjmë asgjë më shumë sesa kemi bërë në ndeshjet kualifikuese, impenjim maksimal, frymë skuadre, besim në skuadër e jo në vlera individuale. Do të vlerësojmë çdo sekondë e minutë. Do ta bëjmë më të mirën e do të synojmë ta kalojmë grupin. Dhe nëse arrijmë, do të jemi të kënaqur. Nëse shkojmë më larg, do të lumturohemi. Por për një gjë jam shumë i sigurt: që tifozët tanë do ta 'skuqin' Gjermaninë, do të na mbështesin pa kursim e kjo do të jetë një tjetër armë e fortë për skuadrën", ka thënë Duka.



Ministrja Manastirliu: Luiza Gega ka marrë 13 shpërblime në dy vitet e fundit

TIRANË, 17 JANAR - Ministrja e Arsimit dhe e Sportit, Ogerta Manastirliu, në një deklaratë për medie, në përfundim të mbledhjes së qeverisë, ka thënë se qeveria i ka mbështetur dhe do të vazhdojë t'i mbështesë sportistët elitare, ku bën pjesë edhe atletja Luiza Gega. Manastirliu u pyet nga gazetarët në lidhje me deklaratat që ka bërë Gega, e cila thotë se nuk ka marrë shpërblime që i takojnë. Ministrja u përgjigj duke thënë se Luiza Gega është e mbështetur jo vetëm në aspektin e shpërblimeve, por edhe atë të krijimit të kushteve për përgatitje.

"Qeveria shqiptare, ministria e Arsimit, është e angazhuar për mbështetjen e sportistëve elitare, ku bën pjesë edhe kampionia jonë Luiza Gega. E kemi treguar jo vetëm për Luiza Gegën mbështetjen sa iu përket atyre aspekteve të shpërblimeve të miratuara në strukturën që bashkërendon ato kriteret të ligjit të sportit. Përtej shpërblimeve, sportistët tanë, ku është edhe atletja kampionia jonë Luiza Gega, janë edhe të mbështetur nga të gjithë aspektet që i përkasin jo vetëm Ligjit për Sportin, por edhe si mbështetje direkte në trupën e FA

me gradën e përcaktuar dhe ne do të vijojmë ta mbështesim në garën ku ajo ka pasur rezultate të larta", ka thënë Manastirliu. "Gjatë vitit 2022-2023 kampionen e kemi mbështetur na garat ballkanike dhe evropiane në 13 mbështetje/shpërblime dhe do të vazhdojmë ta vlerësojmë siç e kemi vlerësuar gjithmonë. Mbështetja nëpërmjet shpërblimeve dhe nëpërmjet sigurimit e kushteve për përgatitje është prioritet absolut. Vlerësimi edhe për rastin konkret të Luizës nuk do të mungojë", ka shtuar Manastirliu.



Rrahmani në formacionin e javës në Serinë A

NAPOLI, 15 JANAR - Amir Rrahmani ishte protagonist në fitoren e Napolit ndaj Salernitanës. Madje ish-futbollisti i Dinamo Zagrebit e Veronës e shënoi golin e fitores 2-1 në minutat shtesë të lojës për t'ia

siguruar tri pikë të vlefshme kampionit aktual italian. Mbrojtësi i Kosovës u përfshi në ekipin e xhiros së 20-të në Serinë A, të përzgjedhur nga faqja "Goal.com". "Napoli iu rikthye

fitores duke e mposhtur Salernitanën në shtëpi dhe këtë e bëri falë një goli të shënuar në minutat shtesë nga Rrahmani. Mbrojtësi jo vetëm që shfaqti siguri dhe kualitet gjatë tërë lojës,

por u bë edhe njeriu vendimtar i ekipit", shkruan kjo faqe. Formacionet: Milkinoviq-Saviq, Holm, Rrahmani, Buongiorno, Hernandez, Adli, Calhanoglu, Lovriq, Vlahoviq, Lautaro, Giroud.

McLaren zbulon njëvendëshen e vitit 2024, objektivi është një vend në podium

WOKING, 17 JANAR - Makina britanike McLaren është e para që ka treguar se si do të jetë njëvendëshja e saj për sezonin 2024 të Formula 1. Kjo makinë do të pilotohet nga Lando Norris dhe Oscar Piastri. Në pritje që pista ta tregojë forcën

reale të makinës McLaren, drejtuesit e saj komentojnë pritshmëritë për vitin 2024. “Kjo është makina jonë, një dizajn fantastik dhe mezi presim ta shohim në pistë përgjatë këtij sezoni”, ka thënë Zak Brown, drejtor sportiv i McLarenit.

“Vjet e nisëm jo mirë kampionatin, por gradualisht u rritëm ndjeshëm dhe duam që këtë ritëm ta vazhdojmë edhe këtë sezon. Vjet hodhëm bazat e ndërtimit të makinës së këtij sezoni”, ka deklaruar Brown. Makina e re McLaren do të

quhet MCL38. Makina do të paraqitet zyrtarisht për mediet më 14 shkurt dhe më pas do të marrë pjesë në testet që do të zhvillohen në Bahrein më 21-23 shkurt. Po në këtë pistë do të zhvillohet edhe gara e parë sezonale e Formulës 1.



Joshua: Ja kush e fiton duelin mes Usykut dhe Furyt

LONDËR, 17 JANAR - Boksieri britanik Anthony Joshua do të ndeshet me ish-kampionin e peshave të rënda të UFC-së, Francis Ngannou. Kjo përballje do të zhvillohet më 8 mars në Arabinë Saudite. Sipas medieve britanike, ka gjasa që fituesi i kësaj sfidë të duelojë me fituesin që do të dalë nga përballja e madhe e 17 shkurtit. Përballë njëri-tjetrit në atë duel do të jenë dy kampionët e botës në peshën e rëndë, Oleksandr Usyk e Tyson Fury. Duke folur për këtë duel, që do t'i unifikojë titujt kampionë bote, Joshua zbulon se cili do të fitojë: “Mendoj se Usyk do t'ia dalë të fitojë. Unë nuk jam shumë i shqetësuar për këtë duel. Unë vetëm dua që ata të dy të jenë të shëndetshëm dhe të largohen nga ringu të shëndetshëm e pa dëmtime. Për sa i përket mënyrës se si do të përfundojë ajo sfidë, kjo nuk më intereson shumë në një farë mënyre. Unë nuk jam si një nga ata fansat që fillojnë të qajnë



sepse dikush fitoi ose humbi. Unë u uroj fat të dyve”, ka shtuar Joshua. Britaniku, që ka humbur dy herë me Usykun, shpreson të zhvillojë një duel me patriotin e tij

Fury. “Më tërheq ideja për ta luftuar Tyson Furyt. Mendoj se kjo është një luftë më e mirë për tifozët dhe veten time”, ka deklaruar Joshua.

Philadelphia mposhti Denverin, triumfon Phoenixi



PHILADELPHIA, 17 JANAR - Ndeshjet e fundit në NBA kanë dhuruar disa surpriza. Kampionët në fuqi të Denverit u mundën me rezultat 126-121 në fushën e Philadelphia.

Një përballje e fortë mes dy ekipesh pretendente Lindje - Perëndim, ku për miqtë shtatë lojtarë realizuan mbi 10 pikë, por që nuk mjaftuan. Për Philadelphia shkëlqeu sërish

Joel Embiid, autor i 41 pikëve e 10 asistimeve. Kjo ishte fitorja e tretë radhazi për vendasit, por që gjithsesi mbeten në vendin e tretë në Lindje, ndërsa humbja zbrit Denverin në vendin e tretë në Perëndim. Fitore në frymën e fundit arriti edhe ekipi i Phoenixit, që mposhti me rezultat 119-117 Sacramento. Allen me 29 pikë e Duranti me 27 bënë dallimin në fushë për ekipin e Sunsit, duke i bërë të pavlefshme 33 pikët e Foxit për miqtë. Humbja e dytë radhazi në Los Angeles brenda 24 orësh për Oklahoma City Thunderin, që u mund me rezultat 128-117 nga Clippersat. Paul George me 38 pikë ishte lider për ekipin kalifornian, ndërkohë që 37 pikë u realizuan nga lojtarët e stolit.

REZULTATET

Philadelphia - Denver	126-121
Phoenix - Sacramento	119-117
Clippers - Oklahoma	128-117

SHKURT

Wolvesi interesohet për Brojën

Sulmuesi i Chelseat, Armando Broja, po kërkohet nga Wolverhampton Wanderers. Sipas mediumit “The Guardian”, Wolverhamptoni po shqyrton një lëvizje për sulmuesin shqiptar këtë muaj. Broja mund të largohet nga Chelsea nëse trajneri Mauricio Pochettino vendos për transferimin e një sulmuesi tjetër. Përveç Wolves, interesim për 22-vjeçarin ka shprehur edhe West Ham Unitedi. Broja ka shënuar dy herë në 17 paraqitje këtë sezon. Potenciali i tij ishte i qartë kur ai bëri përshtypje gjatë një huazimi në Southampton në sezonin 2021/22.

Mbappe: E di që një ditë do të largohem nga Evropa

Kylian Mbappe nuk ka vendosur ende se ku do të luajë sezonin e ardhshëm, por po shikon një të ardhme në Arabinë Saudite ose në ShBA. Sulmuesi francez ka pozuar për revistën “GQ”, ku ka folur edhe për mënyrën e të parit të futbollit dhe çështje të tjera aktuale. “Shumë lojtarë të mëdhenj, që kanë shënuar historinë e futbollit, u larguan nga Evropa verën e kaluar dhe ne po hyjmë në një epokë të re të këtij sporti. Është pjesë e ciklit të tij normal dhe e di që në një moment do të vijë edhe radha ime të largohem. Këto ndryshime nuk më shqetësojnë. Thjesht planifikoj ta vazhdoj karrierën time duke ndjekur rrugën që dua”, ka thënë Mbappe.

Gara për titull? Allegri: Është si loja hajduti dhe polici

Fitorja e pastër 3-0 kundër Sassuolos ngroh trajnerin e Juventusit, Max Allegri, por në çdo rast kur pyetet në lidhje me garën për titull ai qëndron me këmbë në tokë. “Nuk ishte një fitore e lehtë. Sassuolo na vendosi në vështirësi duke detyruar Szczesny të bënte dy ndërhyrje të bukura. Kemi 49 pikë dhe tani mendojmë vetëm për Leccen, duke punuar dhe duke qëndruar në heshtje. Vlahović? Po rritet. Kundër Frosinones luajti keq për 30 minuta pasi dëshironte të shkatërronte çdo gjë. Kundër Sassuolos luajti në një tjetër mënyrë. Ishte më i qartë”, u shpreh Allegri duke bërë në fund një koment epik në lidhje me garën për titull: “Ne nuk po mendojmë për derbin e Italisë, por vetëm për Leccen. Duhet të mendojmë vetëm ndeshje pas ndeshje. Kjo gara për titull është pak a shumë si të luash hajduti dhe polici, hajduti që ia mbath dhe polici që e ndjek”.

Lajm i keq për Bayernin, lëndohet De Ligt

Bayern Muncheni ka marrë një tjetër lajm të keq sa i përket repartit të mbrojtjes, pasi ka mbetur pa një futbollist shumë të rëndësishëm. Mbrojtësi holandez Matthijs de Ligt ka pësuar një lëndim gjatë kampit stërvitor që “bavarezët” po e zhvillojnë në Portugali gjatë këtyre ditëve. Ka qenë faja zyrtare e Bayernit që ka konfirmuar lëndimin e holandezit në gjurin e majtë. “Matthijs de Ligt ka pësuar një dëmtim kapsulë në gjurin e majtë gjatë kampit stërvitor në Faro të Portugalisë. Diagnoza u konfirmua nga departamenti mjekësor i FC Bayern pas një skanimit MRI atje. Prandaj, mbrojtësi nuk do të jetë në gjendje të stërvitet për momentin”, thuhet në njoftimin zyrtar të Bayernit.

Rezultat historik për Lara Colturin, për herë të parë në karrierë në top 10-she

Skiatorja italiane Lara Colturi, që përfaqëson Shqipërinë, ka regjistruar rezultatin e saj më të mirë në garat e Kupës së Botës. Në garën e sllallomit zhvilluar në pistën e Flachaut, në Austri, ajo u

klasifikua në vendin e 9-të. Ky rezultat është më i miri për 17-vjeçarën, teksa për herë të parë në karrierë renditet brenda “top-10” skiatoreve më të mira në Kupën e Botës. Rezultat ky që

konfirmon formën e shkëlqyer të skiatores adoleshente që po befason këtë sezon. Në zbritjen e parë, Colturi regjistroi kohën 55”80, ndërsa në të dytën kronometri u ndal në kohën

56”04. Me kohën e përgjithshme 1’51”84, Lara Colturi e mbylli garën e Flachaut në vendin e nëntë. Tashmë renditja brenda “top-20” po kthehet në një formalitet për skiatoren e lindur

në Itali, por që ka pasaportë shqiptare e garon për ngjyrat kuqezi. Ajo është në sezonin e saj të dytë në Kupën e Botës, por këtë vit ka bërë një hap të jashtëzakonshëm përpara.

Duke u bazuar në Nenin 7, paragrafi 8 të Ligjit Nr. 08/L-145 për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes, Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës e njofton operatorin “Apolloni” SH.P.K. Llazarevë, Obiliq, shfrytëzim i Argjilës, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës organizojnë :

DEBAT PUBLIK

Për aplikacionin për dhënien e Lejes Mjedisore të Integruar

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 08.02.2024 në ora 12:00 në hapësirat e Fabrikës së Bllokave nga Argjila në zonën Industriale Llazarev Obiliq, do të organizohet debat publik nga Operatori “Apollonia” SH.P.K. Llazarev Obiliq, shfrytëzim i argjilës në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Debati Publik do të organizohet për aplikacionin për dhënien e Lejes Mjedisore të Integruar.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis,Neni 16, pika4, Kompania “Ugrija Commere” Sh.p.k. – Prishtinë bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Impiantin për Prodhimin e Sapunëve, Detergjenteve dhe Produkteve tjera të Pastrimit në Llapllasellë, Graçanicë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 05.03.2024 në ora 10:00 në hapësirat e Shtëpisë se Kultures Kishnice, Komuna e Graçanicës, do të organizohet debat publik nga Kompania“Ugrija Commere” – Prishtinë në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/4549344495?pwd=GbKcoccSWx39F3e8QF7PsAkCM3bvK6.1>

Meeting ID: 454 934 4495
Passcode: Aela2019.

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “Ugrija Commere” – Prishtinë për Impiantin për Prodhimin e Sapunëve, Detergjenteve dhe Produkteve tjera të Pastrimit.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis,Neni 16, pika4, Kompania “LURN” Sh.p.k, Prishtinë bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Parkun e Energjisë Solare Fotovoltaik 3 MWp, Z.K. Sinajë, Istog.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 05.03.2024 në ora 11:00 në hapësirat e komunës se Istogut, Shtëpia e Kultures ne Istog, do të organizohet debat publik nga Kompania“LURN” Sh.p.k, Prishtinë në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/4549344495?pwd=GbKcoccSWx39F3e8QF7PsAkCM3bvK6.1>

Meeting ID: 454 934 4495
Passcode: Aela2019.

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “LURN” Sh.p.k, Prishtinë për Parkun e Energjisë Solare Fotovoltaik 3 MWp, Z.K. Sinajë, Istog.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- “ClickAttack” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 810825127.
- Egzon Salihu nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme ekonomike “Kadri Kusari”, Gjakovë.
- Arbër Ahmeti nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10, 11, 12 dhe diplomën e sh.m. “Gjon Nikoll Kazazi” Gjakovë.
- Alfred Pnishi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10, 11, 12 të sh.m. Teknike “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.
- Ulvije Rexha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m. “Mustafa Bakija” nga kl. I-IX.
- Rasim Kokalla nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e A.P. “Hysni Zajmi” Gjakovë.
- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)



Në bazë të nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Kompania Rajonale e Mbeturinave (KRM) “Pastrimi” SH.A në Prishtinë, shpall këtë:

KONKURS

Titulli i pozitës: *Shef i Administratës – 1 pozitë*
Institucioni: *Kompania Rajonale e Mbeturinave (KRM) “Pastrimi” SH.A – Prishtinë*
Titulli i Mbikëqyrësit:/Raporton tek: *Sekretari i Ndërmarrjes*
Orari i Punës: *40 orë në javë*
Kohëzgjatja e emërimit: *me afat të pacaktuar*
Detyrat dhe përgjegjësitë: *(përshkrim i shkurtër i detyrave kryesore)*

- Përcjell realizimin dhe ekzekutimin e vendimeve dhe komisioneve të KE-së;
- Bënë menaxhimin dhe ofrimin e rregullorve të kompanisë dhe legjelacionit në fuqi;
- Kujdeset për ofrimin e shërbimeve administrative përkatësisht, zyrës së përfaqësimeve, arkivës, zyrës për mbrojtje dhe siguri punë, shërbimit të sigurimit, byfës, pastruseve;
- Përcjell punën dhe matë performancën e Shërbimit juridik, bashkëpunon me departamente tjera të kompanisë në mënyrë që të gjitha vendimet dhe veprimet e menxhmentit të ekzekutohen në interes të kompanisë si dhe të krijoj bashkpunim me departamentet dhe palët tjera;
- Krijon politika për avancimin dhe përgaditjen e personelit në qështjet ligjore, procedura administrative që hyjnë në kuadër të detyrave të depaetamentit, harton raporte të rregullta për kryerjen e punëve dhe detyrave në koordinim me Sekreaterin;
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së udhëheqësit të drejtpërdrejtë.

Shkathtësitë e kërkuara: *(aftësitë dhe shkathtësitë që kërkohen për këtë vend pune)*

- Shkathtësi në komunikim dhe planifikim të punës;
- Aftësi bashkëpunimi, ndërpersonale si dhe pune në grup;

Kualifikimet arsimore, profesionale dhe përvoja e punës: *(kualifikimet dhe përvoja që kërkohen për këtë vend pune)*

- Diplomë Universitare;
- Tri (3) vite përvojë pune profesionale;

Konkursi është publikuar më datë 18 Janar 2024 dhe mbyllet më datë 01 shkurt 2024.

APLIKACIONI: Në aplikacion duhet të bashkëngjiten dokumentet e nevojshme për konkurim, siç janë:

1. Kopja e letërnjoftimit;
2. CV-ja e kandidatit;
3. Kopja e Diplomës Universitare;
4. Dëshmija mbi provojën e punës.
5. Çetrtifikata që nuk jeni nën hetime.

MËNYRA E APLIKIMIT:

Formulari i aplikacionit merret dhe dorëzohet në pliko (zarfë) të mbyllur në arkivën e KRM “Pastrimi” SH.A, Rr. “Tahir Zajmi”, Nr.5, Prishtinë.

Aplikimi përmes postës: Aplikacioni i kompletuar me dokumente mund të dorëzohet edhe përmes postës në adresën: Rr. “Tahir Zajmi”, nr.5, Prishtinë, 10000. Aplikacionet e dërguara me postë duhet të mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim. Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 3 tri ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara, nuk do të shqyrtohen fare.

KUSHTET E Pjesëmarrjes në Konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

KRM “Pastrimi” SHA ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

VËREJTJE:

APLIKACIONET DHE DOKUMENTACIONI I PAKOMPLETUAR SIPAS KËREKSAVE TË PËRCAKTUARA NË KËTË KONKURS SI DHE ATO QË ARRIJNË PAS SKADIMIT TË AFATIT TË KONKURSIT, NUK DO TË SHQYRTOHEN.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi është i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit.Për informata më të rëndësishme mund të kontaktoni në nr. tel: +383 (0) 38 603 191



Prema çlanu 8. Zakona br. 03/L-212 rada, član 4 Upravnog uputstva br.07/2017 o regulisanju postupka konkurencije u javnom sektoru, Regionalno preduzeće za otpad (KRM) "Pastrimi" SH. U kuranu izjavljuje:

KONKURS

Naslov kancelarije: *Šef uprave – 1 pozicija*
Institucija: *Regionalno preduzeće za otpad (KRM) "PASTRIMI" SH. A – Priština*
Naslov supervizora: *Izveštaj sekretaru društva*
Radno vreme: *40 sati nedeljno*
Trajanje zakazane obaveze: *neodređeno vreme*
Dužnosti i odgovornosti : *(kratak opis glavnih zadataka)*

- Nadgleda izvršenje i izvršenje odluka i komisija EK;
- Upravlja i obezbediti propise kompanije i ozakoniti na snazi;
- Briga o pružanju administrativnih usluga , odnosno predstavništvo, arhiva, kancelarija za zaštitu i rad obezbeđenja, služba bezbednosti , biro, čistači;
- Prati učinak i učinak Pravne službe, sarađuje sa drugim odeljenjima preduzeća tako da se sve odluke i radnje rukovodstva izvršavaju u interesu preduzeća i uspostavljaju saradnja sa odeljenjima i drugim strankama;
- Kreira smernice za unapređenje i obezbeđivanje kadrova u pravnim pitanjima, administrativne procedure koje spadaju u poslove odeljenja, sazivanje redovnih izveštaja za izvođenje radova i zadataka u koordinaciji sa Sekretarom;
- On takođe obavlja druge zadatke na zahtev direktnog lidera.

Potrebne su veštine : *(potrebne veštine i veštine za ovaj posao)*

- Veštine komunikacije i planiranja rada;
- Saradničke, međuljudske veštine i timski rad;

Kvalifikacije za obrazovno, profesionalno i radno iskustvo: *(kvalifikacije i iskustvo potrebno za ovaj posao)*

- Univerzitetska diploma;
- Tri (3) godine profesionalnog iskustva;

Konkurs je objavljen 18. januara 2024. godine, a zatvara se 01. februara 2024. godine.

Prijava: Prijava mora da sadrži potrebna dokumenta za konkurs, kao što su:

1. Kopija ID-a;
2. CV kanadanina;
3. Kopija univerzitetske diplome;
4. Dokaz rada.
5. Potvrde da niste pod istragom.

MËNYRA E APLIKIMIT:

Prijavni formular se uzima i podnosi u zatvorenoj koverti u arhivi KRM "Pastrimi" SH. A, "Tahir Zajmi" St., br.5, Priština.

Prijava poštom: Prijava kompletna sa dokumentima može se podneti i poštom na adresu: "Tahir Zajmi" St., br.5, Priština, 10000. Prijave poslate putem pošte treba da zadrže žig na pošiljki izvršenoj poslednjeg dana isteka roka za prijavu. Prijave poslate putem pošte, koje nose poštansku marku na pošiljki izvršenoj poslednjeg dana isteka roka za prijavu, smatraće se važećim i biće razmotrene ukoliko stignu u roku od 3 tri dana. Prijave koje stignu posle ovog roka i nekomplikovane uopšte neće biti razmatrane.

USLOVI UČEŠĆA NA KONKURSU:

Pravo na primenu imaju svi građani Republike Kosovo starosne dobi većine koji imaju punu sposobnost da deluju, poseduju građanska i politička prava, poseduju neophodnu obrazovnu pripremu i stručnu sposobnost obavljanja zadataka i koji poseduju fizičke veštine potrebne za obavljanje odgovarajućeg položaja.


KRM "Pastrimi" AD nudi jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i pozdravlja prijave svih muških i ženskih osoba iz svih zajednica na Kosovu.

UPOZORENJE:

PRIJAVE I NEKOMPATIBILNA DOKUMENTACIJA PREMA ZAHTEVIMA NAVEDENIM NA OVOM KONKURSU I ONIMA KOJI STIGNU PO ISTEKU ROKA KONKURSA NEĆE BITI RAZMATRANI.

Biće kontaktirani samo kandidati koji su ušli u uži izbor.

Konkurs je otvoren 15 dana od dana objavljivanja. Za više informacija možete nas kontaktirati na br. Tel: +383 (0) 38 603 191



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Berisha” SH.P.K. me seli në Fushë Kosovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810643123 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Berisha” D.O.O. Fushë Kosovë, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810643123 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Berisha” L.L.C. with headquarters Fushë Kosovë, has come to the decision to quit its business: 810643123 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



100% Fresh & Natural

VIDAS Llatte drink 2%

VIDAS TAMËL 2,8%

VIDAS Schmand 18% yndyrë 800g

VIDAS JOGURT 100% i Freshet Natural

VIDAS DHALLË 100% i Freshet Natural



TRADITË QË NGA

1992

